

VENDIM
Nr. 155, datë 27.2.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION
TË HIDROCENTRALIT “MALLA” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN
PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3 e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Malla” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën për zgjedhje konkurruese për dhënie me koncesion të këtij hidrocentrali, që i jepet shoqërisë “Marsian Service”, sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën për zgjedhje konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Malla”, duhet të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha